

**2** **Klinika Hirlanden diskriminon punonjëset Beteja e pastrueseve vazhdon më tej**

**3** **Intervistë me sekretaren për barazi në Unia «Nënat shihen si punëtore të këqija»**

**4** **Kontributi i disaporës për botën e punës Për sindikata të fuqishme në Kosovë**

Nr. 2 | prill 2022 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kongresi i Unia i zhvilluar në shtëpinë e kongreseve në Biel

## Koha e fundit për më shumë mbrojtje të largimit nga puna!



Pamje nga dita e tretë Kongresit të Unia dhe ndjekja e vëmendshme e punimeve nga Grupi i Interesit të Migracionit.

Dita e tretë e Kongresit të Unia tani së fundi, pas dy ditësh digjitale vitin e kaluar për shkak të koronës, u zhvillua përsëri në mënyrë analoge. Përqendrimi ishte tek një projekt-iniciativë e re.

work, 4 mars 2022 (përshtatur nga Marilia Mendes)

Zvicra ka një ligj shumë të brishtë të punës. Shoqatat e punëdhënësve dhe partitë e djathta e quajnë ligjin «liberal» pasi që është i favorshëm për punëdhënësit. Në përditshmëri dhe punës kjo konkretisht domethënë: punëmarrësit nuk janë fare të mbrojtur prej largimit nga puna. Edhe në qoftë se një gjykatë e konsideron si keqpërdorim largimin, nuk ekziston e drejta e kthimit në vendin e punës. Ndërsa kompensimet financiare janë të dobëta. Përderisa për shtatzënat vlen së paku një mbrojtje minimale, punonjësit të moshuar dhe që angazhohen në sindikatë, faktikisht i nënshtrohen mëshirës e vullnetit të punëdhënësit. Tani këtë gjendje duan ta ndryshojnë delegatët e Unia.

### Dokumentet e pozicionimit dhe projekt-iniciativat

Deri tek të erdhe në këtë mënyrë: Organet e Unia i përpunuan katër dokumente pozicionimi, të cilat u shqyrtuan në këtë ditë të tretë të kongresit. Fjala është për temat «Balanca

sociale dhe siguria shoqërore». «Më shumë mbrojtje dhe të drejta të njëjta», «Punë të mirë për një jetë më të mirë», «Një tjetër ekonomi është e mundur dhe e nevojshme». Pastaj u shtrua edhe pyetja: «Çka mund të bëjmë ne, që diskutimi i rëndësishëm dhe pozicionimi të mos mbesin vetëm në letër, por që të ndikojë edhe praktikisht në orientimin politik të Unia?».

Rezultati i këtyre shqyrtimeve qoi në katër ide për iniciativa tematike:

- Zgjerimi i mbrojtjes ligjore inë rast largimi nga puna,
- Zvogëlimi i kohës së punës fitimprurëse,
- Financimi i drejtë social i rishtruktimit socio-ekologjik,
- E drejta për punë ose një «garanci pune» publike.

### Përcaktimi për një ide iniciative

Shkaku se nuk ekzistojnë resurse të mjaftueshme për të nisur kaq shumë iniciativa, delegatët e kongresit duhej

të vendosnin për një projekt: me 104 vota delegatët vendosën për projektin e mbrojtjes nga largimi kundrejt 96 votave për «Zvogëlimin e kohës së punës»

### Mbrojtja nga shkarkim-largimi dhe ...

Unia në vitet vijuese do të angazhohet në Bashkimin e Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) për një nismë, e cila do të përmirësojë mbrojtjen nga largimi për të gjithë në Zvicër. Pasi: qoftë dumpingu në paga, mungesa e sigurisë ose pabarazia në paga: Punëmarrësit duhet të kenë mundësinë që ti drejtohen sindikatave, pa pasur frikë, se do të humbin vendin e punës. Mbrojtje të veçantë përpos përfaqësuesve të personelit duhet të kenë edhe punëmarrësit, të cilët lehtë mund të shtrydhen lehtësisht nga tregu i punës, si fjala bie gratë pas pushimit të lehonisë, punëmarrësit e moshuar apo njerëzit me status të pasigurt.

### ... Zvogëlimi i kohës së punës

Por Unia do të angazhohet edhe më tej për zvogëlim efektiv të kohës së punës. Pasi edhe ky është një preokupim i vjetër sindikalist. Me këtë mund të arrihet një ndarje më e drejtë e punës me pagesë dhe fjala bie ajo e përkujdesjes mes gjinive, mirëpo gjithashtu të garantohet edhe mbrojtja e shëndetit.

### Rezolutat

Kongrese në fund të punimeve aprovoi shtatë rezoluta, mbi temat si «Shëndeti është qendror për dinjitetin e punëmarrësve»; «Të siguruarit e financave dhe përfitimeve publike»; «Lufta jonë fuqizon KKP tona – KKP tona përmirësojnë kushtet tona të punës» dhe një rezolutë mbi luftën kundër Ukrainës me titullin «Kurrë më luftë»

### Rishikimi i kongresit të Unia:

Rezolutat, videot dhe fotografitë mbi ditën e kongresit 2022 i gjeni këtu: [rebrand.ly/kongress-2022](https://rebrand.ly/kongress-2022)

## Editorial



### Angazhimi ynë për vitet që po vijne

Marrë parasysh pabarazinë sociale dhe sigurinë, ne në Kongresin e 4-të të Unia kemi ngritur zërin tonë solidar për angazhimin luftarak. Ne me këtë rast kemi identifikuar dy akse kryesore: mbrojtjen dhe solidaritetin. Është koha e fundit! Pasi, çdokush që humb vendin e punës, humb edhe resurset e veta, rrezikon humbjen e lejes së qëndrimit dhe/ apo përkeqësimin e shëndetit personal. Para së gjithash, p.sh. nëse nuk posedohet pasaporta zvicerane, nëse është fjala për nënë apo për të moshuar. E njëjta vlen edhe nëse dikush gabimisht kategorizohet si «i pavarur» apo «i vetëpunësuar». Dhe kushdo që jeton në një vend, në të cilin mbretëron lufta, është i rrezikuar më së fort.

Ne kemi vendosur që në lidhje me këtë të japim një përgjigje pro aktive: Mbrojtja. Mbrojtje për të gjithë punëmarrësit pa përjashtim, që të vlejë të drejtat e punës dhe sigurisë shoqërore për të gjithë. Mbrojtja nga largimi nga puna. Mbrojtja nga pasojat e luftës.

Mjeti, për të arritur këtë mbrojtje, është solidarizimi ynë. Kërkesat tona do të dëgohen vetëm atëherë kur ne të vazhdojmë luftën e paraardhësve tanë. Veçanërisht ne kemi shumë kurajë, pasi kemi arritur një aftësi të madhe organizative dhe një rrjet të anëtarëve aktiv. Për të rritur e zhvilluar ndikimin tonë efektiv dhe ofensivë karshi forcave institucionale dhe ekonomike, ne duhet të rrisim më tej numrin e anëtarësisë tonë, të mbështesim pa përjashtim kolegeve dhe kolegëve tanë dhe të përfshihemi aktivisht në arritjen e qëllimeve tona. Kjo bëhet përmes pjesëmarrjes sonë, mobilizimit tonë dhe besimit në organizatën tonë dhe përfaqësuesit tanë.

E gjitha varet nga ne!

Marie Saulnier Bloch



## News

## Rritet presioni karshi Smood

Në fillim të marsit 2022 në Gjenevë: Kurirët e Smood përmes një aksioni kreativ e të angazhuar kërkuar kushte më të mira pune. Të hënën e fundit të muajit ata morën mbështetje nga qendra e arbitrazhit të Gjenevës CRCT. Në rekomandimet e tyre zyrtarët i mbështesin kërkesat, për të cilat kurirët vitin e kaluar kanë bërë grevë. Edhe qeveria e Gjenevës fuqizon, se bisedimet duhet të vazhdojnë. Pos kësaj qeveria ka kërkuar nga inspektorati i punës që të përpilojnë një raport mbi kushtet e punës tek Smood. Unia dhe kurirët kërkojnë, që Smood të zbatojë menjëherë rekomandimet e CRCT. Pos kësaj kantonet duhet të jenë më aktive, për të rregulluar më mirë ndërmarrjet e platformave (online).

## Shoferët e shkarkuar të DPD: Nënshkruaj tani shkresën ndërkombëtare të protestës

Në fillim të vitit, pesë shoferë të DPD në Ticino dhe sindikalistë aktivë u pushuan nga puna nga nënkontraktorët e tyre. Më pas ata protestuan në Paris para selisë qendrore të DPD-së La Poste kundër qëndrimit anti-punonjës të DPD-së. Unia dhe organizata ombrellë e sindikatës ndërkombëtare UNI Global Union po kërkojnë që shoferët të rikthehen menjëherë në punë. Për këtë qëllim, UNI Global Union ka nisur një letër proteste ndërkombëtare. Nënshkruaj tani letrën e protestës: <https://actionnetwork.org/letters/dpd-ticino-de/>


## Referendumi AHV/AVS 21: Reduktimi i AHV/AVS trazon vendin

Një aleancë e gjerë kundër reduktimit të AHV/AVS-it ka mbledhur tashmë më shumë se 100 000 nënshkrime për referendumin kundër AHV/AVS 21 në më pak se 50 ditë, pra në gjysmë të afatit të periudhës së referendumit. Përkundër ditëve të ftohta të dimrit dhe kufizimeve të pandërprera të koronës është startuar me shpejtësi referendumi kundër rritjes së moshës së pensionimit për gratë. Referendumi kundër AHV/AVS 21 u ndërmor nga sindikatat, partitë, shoqatat dhe kolektivet feministe. Mbledhja e nënshkrimeve do të vazhdojë më tej. Afati i fundit për nënshkrime ishte data 20 mars. Informacione të mëtejshme për referendumin: [www.ahv21-nein.ch](http://www.ahv21-nein.ch)

## Referendumi NoFrontex

Dhuna, mjerimi dhe vdekja janë bërë pjesë e jetës së përditshme në kufijtë e jashtëm të Evropës. Refugjatët privohen nga të drejtat e tyre, rrihen dhe dëbohen. Frontex, si roje evropiane kufitare dhe bregdetare, është bashkëpërgjegjëse. Akuzat kundër Frontex peshojnë rëndë: mungesa e transparencës, shikimi anash kur bëhen shkeljet dhe pjesëmarrja në cenimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, ka plane për të rritur masivisht agjencinë Frontex – edhe me para nga Zvicra. Më 15 maj, ata që kanë të drejtë vote në Zvicër do të votojnë për zgjerimin e agjencisë së mbrojtjes së kufijve të BE-së, Frontex. Përveç kësaj, trupat e rojeve kufitare zvicerane do të marrin pjesë gjithnjë e më shumë në operacionet e armatosura të Frontex jashtë vendit.

Aktivistët dhe organizatat e bazës të afërta me Rrjetin e Solidaritetit të Migrantëve kanë ndërmarrë me sukses një referendum. Tani një aleancë e gjerë e kolektivëve bazë, organizatave, partive dhe kishave po bën fushatë për një JO në 15 maj.



## Klinika Hirslanden hedh pastrueset në rrugë

## Lajmi i keq para daljes në pension

Ka 25 vite që Finka Erceg dhe 7 koleget e saj pastrojnë spitalin Linde në Biel. Tani drejtorja e klinikës ka vendosur të shkarkojë që të gjitha. Por gratë po rezistojnë.

Hilmi Gashi

Ndihet një atmosferë mbresëlënëse e solidaritetit kur Döndü Elmali, Finka Erceg, Matilde Dos Santos Diogo, Ljubica Crnogorac kur dalin në tribunën e sallës së Kongresit. Të shoqëruara me një duartrokitje të fuqishme të delegatëve të Unia. Finka flet në mikrofon. «Ne ditë për ditë kemi mbajtur të pastër klinikën, me vite të tëra. Ne kemi qenë gjithmonë të përziemert me pacientet e pacientët. Por tani ne kemi nevojë për mbështetje!». Ajo flet për veti dhe për koleget e saja, të cilat do të humbin vendin e tyre të punës. «Ne nuk pajtohemi. Drejtorja e spitalit nuk bisedon me ne. Pas të gjitha këtyre viteve ne kemi merituar më shumë.»

## Tronditja para Krishtlindjeve

Me 7 dhjetor ato ftohen në një mbledhje. Drejtorja i informon ato, që pastrimi do të bëhet me kontraktim të jashtëm. Për pastrueset kjo domethënë: Ato do të shkarkohen nga puna për në fund të marsit 2022. Në një prononcim për Work, Hirslanden shkruan, se «një vendim i tillë është marrë shkaku i aspekteve të larta organizative dhe financiare». Se klinika është «goditur rëndë» nga pandemia dhe se është dashur të bëhet më «fleksible». Matilde Dos Santos Diogo thotë: «Drejtorja e klinikës na ka premtuar se gjithçka do të mbetet njëjtë. Se ne do na merr përsipër firma e re». Mirëpo kur ne morëm kontratat e reja u bë e qartë: Punonjëset do të marrin 500

deri 900 franga më pak pagë dhe se do të duhet të punojnë për 3300 franga në muaj.

## Mbështetje nga Unia

Ato drejtohen tek Unia Biel. Drejtuesi regional Alain Zahler gjen fjalët kuptimplota: Pikërisht tek pagat e ulëta të fillohet të ofrohen paga edhe më të reduktuara, kjo është një «tallje». «Hirslanden dëshiron të kursejë në kurriz të pastrueseve». Një petition i startuar nga Unia menjëherë është nënshkruar nga 200 punonjës: e të spitalit Linde. Njeriu i Unia, Zahler thotë: «Solidariteti i madh ndodh rrallë». Mirëpo, drejtorja e klinikës mbetet e shurdhur dhe donë «biseda individuale me të prekurit». Beteja e pastrueseve vazhdon më tej.



Foto@Lucas Dubuis

(v.l.) Döndü Elmali, Finka Erceg, Matilde Dos Santos Diogo, Ljubica Crnogorac

## Zhvillimet e pagave

## Përkundër rimëkëmbjes ekonomike, nuk ka hapa përmirësues për punëmarrësit

Vitin e kaluar shumë punëdhënës krizën e koronës e shfrytëzuan si mbulesë, për t'ua mohuar punëmarrësve rritjen e pagave. Sivjet vit u mundësua prapë një përmblyllje pozitive, mirëpo rritja e pagave shpesh mezi i afrohen shtrenjtimit.

Noémie Zurlindeni

## Ndikimet e pabarabarta të krizës së koronës

Kriza e koronës nuk i godet të gjithë njëjtë. Përderisa menaxherët drejtues dhe aksionarët arkëtuan edhe më tej para, shumë punëmarrësve iu deshtë që të bartin rreziqet shëndetësore në vendin e punës dhe të vuajnë nën punën me kohë të shkurtuar apo edhe me papunësi. Pos kësaj vitin e kaluar nuk kishte ngritje pagash.

## Rundi i pagave 2021/2022: Rekord i nënvizuar

Marrë parasysh rimëkëmbjen ekonomike do të duhej që më në fund edhe punëmarrësve për angazhimin e tyre gjatë krizës të kompensohen. Mirëpo jo të gjithë e shohin këtë si të nevojshme. Shoqata e ndërtuesve për shembull ua mohon punëtorëve të ndërtimit edhe përkundër gjendjes së porosive rekorde çfarëdo rritje pagash. Kjo është absolutisht e pranueshme.

Mirëpo, Unia arriti qysh tani të shënon suksese. Pas një viti gjendjeje pa kontratë që nga fillimi i vitit 2022 për zejtarinë e zdrukthëtarisë kemi prapë një KKP – me paga minimale më të larta. Rritje tjera të pagave minimale patëm për shembull edhe tek KKP për personelin e huazuar.

Në industri janë përfunduar rritje të ndryshme individuale pagash për rreth 1%. Rritje individuale pagash, për dallim nga ato gjeneralë, janë shpërndarë sipas kritereve të ndryshme. Jo të gjithë punëmarrësit marrin automatikisht rritjen e pagave. Në sektorë e ndërmarrje të ndryshme të degëve të industrisë, ndërtimtarisë, zëjtarisë dhe terciar janë arritur megjithatë rritje gjeneralë të pagave, për shembull për rreth 1% në industrinë e orëve dhe mikroteknologjisë si dhe në sektorin elektrik.

Rritja e pagave shpesh gati se është i njëjtë me rritjen e inflacionit. Punëmarrësit pra nuk mund të kontribuojnë më shumë se sa përpara, por maksimalisht po aq sa deri me tani. Marrë parasysh përpjekjet e punëmarrësve nën kushte të vështirësuar përgjatë pandemisë janë të nevojshme dhe të udhës përshtatje të mëdha pagash. Qysh para një viti punëdhënësit shfrytëzuan krizën e koronës si arsytim, për të mos kompensuar drejtë punëmarrësit – kësaj praktike duhet dhënë fund.



## 8 Marsi: Gratë luftojnë

Motoja e 8 Marsit:  
Paga më të larta, paqe

Në shumë qytete të Zvicrës janë zhvilluar aksione për më shumë pagë dhe kundër rritjes së moshës së pensionit tek gratë si dhe për paqe. Me mijëra gra kanë marrë pjesë në këto aksione.

Emine Sariaslan

Në kantonet Bernë, Luzern, Cyrih, Valis, Gjenvë, Neuenburg, Vaud dhe Tiçino janë zhvilluar aksione të shumta. Ato kanë qenë të llojllojshme: festë me ushqime dhe muzikë, promovim e prezantim librash, stenda informuese, demonstrata etj. Sivjet dy tema ishin në qendër të vëmendjes: Paga më të larta në vend të rritjes së moshës së pensioneve dhe paqja.

## Nuk e pranojmë reformën e pensioneve AHV/AVS21

Me 8 mars gratë përmes stendave dhe aksioneve të zëshme kanë tërhequr vëmendjen mes pagave e pensioneve të ulëta dhe varfërisë në pleqëri. Sloganet e tyre ishin: «Paga më të larta në vend të rritjes së moshës së pensionimit!». Gratë në Zvicër fitojnë 20% më pak se burrat. Pos kësaj ato punojnë shpesh pjesërisht. Shtojnë edhe kujdesin për fëmijët dhe familjarët krahas punës në sektorët më paga tejet të ulëta (përkujdesje, pastrim, gastronomi etj.). Pasojat e drejtpërdrejta: pensione të ulëta pleqërie. Me paga më të larta, gratë do të paguanin më shumë kontribute dhe do të përfundonin rrugëtimin e tyre profesional me një pension më të denjë.

## Paqe tani, solidarizimi feminist

Gratë kanë mbajtur fjalimet e tyre mbi paqen dhe janë deklaruar kundër luftës me kërkesë për paqe të menjëhershme: mbi 2 milion njerëz gjenden në arrati. Nga ta janë shumë gra, fëmijë e njerëz të moshuar. Ata janë shpesh të shpërndarë nga përditshmëria e tyre dhe gjenden në një situatë emergjente. Mbretëron uria e mjerimi. Asnjë komb nuk mund të arsyetojë sulmin ushtarak në një vend tjetër. Ne solidarizohemi me viktimat e sulmit dhe kërkojmë nga Rusia, që menjëherë të tërhiqet nga Ukraina dhe regionet e pushtuara.

Nga NATO-ja dhe BE-ja ne kërkojmë të ndjekë politikë të de-përshkallëzimit. Duhet të fuqizohet solidarizimi me njerëzit në vend dhe ata që gjenden në arrati. Zvicra duhet të pranojë refugjatët me zemërgjerësi dhe të bëjë gjithçka që është e mundur që të ndihmojë njerëzit në vetë Ukrainën dhe në vendet fqinje.

## Kundër dhunës ndaj grave

Një temë tjetër në aksione ishte «Ndal dhunës ndaj grave». Çdo dy javë në Zvicër vritet një grua apo vajzë. Përtej kësaj së paku një herë në javë, një grua apo vajzë janë viktime të tentim vrasjes. Organizatat e grave kërkojnë, që Zvicra të bëjë gjithçka, të ndalojë çfarëdo lloji të dhunës dhe të mbrojë të prekurat. Në këtë kuadër Zvicra duhet të zbatojë Konventën e Stambollit («Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje» të Këshillit të Evropës të vitit 2011) dhe të fuqizojë ligjin penal seksual, që dënon përdhunimin sipas parimit «Vetëm po d.m.th. po». Konventa e Stambollit kërkon edhe vende të mjaftueshme në shtëpitë e grave.

## Migrantet kanë qenë pjesë aktive

Në aksione kanë marrë pjesë migrante të shumta dhe i kanë adresuar zëshëm kërkesat e tyre: Njohja e diplomave të huaja, luftimi i diskriminimit të dyfishtë, Reduktim të pengesave përkitazi me natyralizim. Pranimi i temave specifike të grave si arsye për fitimin e azilit, barazi mundësisht dhe drejtësi në vendin e punës, e në shoqëri. Migrantet luftojnë plotësisht në kuptimin e Clara Cetkin: «Të luftohet, aty ku është jeta.»



Pamje nga një aksion i sivjemë i grave ku kundërshtohet rritja e moshës së pensionit për gra, pabarazia, ngacmimi dhe dhuna seksuale

## Lufta në Ukrainë

Sulmi brutal i kryetarit të Rusisë Putin kundër Ukrainës domethënë mjerim, vdekje dhe shkatërrim. Shumë shtetas ukrainas nga bota e jashtme janë kthyer mbrapa, për të mbrojtur atdheun e tyre. Shumë të tjerë për këtë janë detyruar të lëshojnë Ukrainën. Me 8 mars kanë qenë mbi 1 milionë. Një sindikalist ukrainas, Witalij Machinko nga Trudowa Solidarnost të Kievit, tregon se çfarë sfidash mund të sjellë kjo gjendje.

Marek Wieruszewski

Witalij është mirënjohës për pranimin e ukrainaseve të ikur, megjithatë shprehë di-sa mëdyshje: «Ata do të jenë të detyruar, të kryejnë punë të ndryshme. Unë jam shumë i merakosur mbi këtë shfrytëzim të qytetarëve ukrainas, që është në kundërshti enorm me ligjin. Sipas mendimit tim do të jetë më keq se sa më 2015 dhe 2016. Edhe pse deri më tani pak a shumë ka qenë më e kontrolluar, tash ky problem me një valë të tillë refugjatësh do të jetë shumë më akut se sa ai i para 6-7 viteve.»

## Detyra të mëdha për sindikatat

Witalij është i bindur se këtu duhet të ketë një mbështetje të madhe nga sindikatat: «Andaj na nevojitet ndihma e sindikatave europiane, për të ndihmuar punëmarrësit ukrainas për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Që qytetarët e Ukrainës sa më pak që është e mundur ti nënshtrohen shfrytëzimit të paligjshëm nga ana e ekonomisë.» Njerëzve nuk u nevojitet mbrojtje vetëm nga lufta, porse edhe perspektivë për një jetë me dinjitet.

Intervista është botuar në faqen e internetit të sindikatës polake OZZIP Inicjatywa Pracownicza Ogólnopolski Związek Zawodowy (ozzip.pl)



## Intervista Aude Spang



## Bisedë me Aude Spang, sekretare për barazi në Unia «Nënat shihen si punëtore të këqija»

Gratë në tregun e punës i nënshtrohen diskriminimit strukturor. Gratë fitojnë rreth 20% më pak se sa kolegët e tyre meshkuj. Por jo vetëm pabarazia në paga është një problem: Ka edhe raste, kur gratë për shkak të gjinisë së përkrahur as që mund ta fitojnë vendin e punës. Shtatzënia dhe lehonja në këto raste shihen shpesh si shkaqe. Horizonte flet me Aude Spang për një rast të tillë, i cili ka ndodhur në kantonin Neuchatel. Aude Spang është sekretare për barazi në Unia.

## Në fillim të shkurtit një punonjëse e McDonalds arriti një fitorë para gjykatës. Punëdhënësi i saj u fajësua për diskriminim shkak i gjinisë. A mund të na japësh kontekstin për rastin në fjalë?

AS: Fjala është për një grua, e cila ka punuar tek McDonalds në Marin-Epagnier (NE). Ajo ishte e interesuar për një vend pune si menaxhere dhe ishte ftuar për një bisedë punësimi. Gjatë bisedës ajo ka përmendur se do të martohet. Si rezultat i kësaj, ajo nuk e morri vendin e punës: Përmes martesës ka gjasa që ajo të bëhet edhe me fëmijë.

## Një gruaje i refuzohet vendi i punës, vetëm pse merret me mend, që ajo mund të bëhet me fëmijë. A do ti ndodhte kjo edhe një burri?

Në rastin konkret gruas në fjalë i është thënë qartas, se asaj kjo nuk do ti ndodhte. Ky është një rast i qartë i diskriminimit në bazë të gjinisë. Shpesh burrat vlerësohen, kur ata bëhen etër. Nën, nga ana tjetër, shihen si punëtore gjoja më të këqija dhe diskriminohen. Ky moral i dyfishtë është i papranueshëm, mirëpo shumë i zakonshëm.

## Në këtë rast ka ndodhur diskriminimi bazuar në një paramendim dhe jo shkak i amësisë faktike. Të flasim edhe për mbrojtjen e amësisë në Zvicër. Si qëndron puna tek diskriminimi i nënave?

Shtatzënia i vë shumë gra në një pozitë më të keqe në tregun e punës. Çdo e 10 grua pas pushimit të lehonisë shkarkohet nga puna. Kjo natyrisht se nuk është e njëjta, sikur kur bëhet fjalë për mos marrjen në punë, pasi njeriu është grua. Mirëpo, këto problematika janë të ndërlidhura me njëra tjetër – në të dyja rastet kemi të bëjmë me diskriminim në bazë të gjinisë.

## Në rastin e punonjës së McDonalds Unia ka mbështetur procesin gjyqësor: Ky proces është fituar. Përse janë këto raste aq relevante?

Unia angazhohet për të drejta të barabarta dhe të drejta më të mira të grave në punë. Kur ne fitojmë rastet e tilla, gjykatat në të ardhmen duhet të mbështeten në këto shpallje ligjore. Kështu merren vendime, të cilat janë në kuptimin e barazisë.

## Çka duhet të ndryshojë në të ardhmen, për tu mos diskriminuar më gratë në botën e punës?

Gratë duhet të organizohen së bashku, të bisedojnë me kolegët dhe të luftojnë së bashku. Ato duhet të angazhohen bashkë me sindikatat kundër diskriminimit. Ne nuk kemi fituar asgjë, pa luftuar!

Sarah Heinzmann



## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Mëditjet në rast sëmundjeje: Çka ndodh pas dorëheqjes?

Unë ka tre muaj që jam 100% i sëmurë me dëshmi mjekësore. Tani shefi im më ka dhënë dorëheqjen. Pasi firma ime për punonjësit ka lidhur një sigurim kolektiv shëndetësor, unë marr mëditjet e sëmundjes nga sigurimi. Mirëpo çka mund të ndodh? A i humbi bashkë me vendin e punës edhe mëditjet e sëmundjes?



I SËMURË ME DËSHMI: Me një sigurim të mëditjeve në rast sëmundjeje ju jeni i siguruar edhe pas dorëheqjes. (Foto: iStock)

**Myriam Muff:** Jo. Interesohuni tek firma juaj ose edhe më e sigurtë – drejtpërdrejt tek sigurimi i mëditjeve të sëmundjes, se a bazohet sigurimi në ligjin e sigurimit shëndetësor (KVG/LAMal) apo në ligjin i sigurimit kontraktës (VVG/LCA). Të dyja llojet e sigurimit shëndetësor kolektiv në Zvicër janë vullnetare.

**ME PËRPARËSI:** Disa firma në bazë të Kontratës Kolektive të Punës janë të obliguara të lidhin një sigurim shëndetësor. Nëse kjo nuk është bërë, firmat mund të zgjedhin vet, se a duan të lidhin një sigurim të tillë, si dhe, a duhet të jetë ai në bazë të KVG/LAMal apo të VVG/LCA. Pa një sigurim të tillë, ndërmarrjet bazuar në të drejtën obligative janë të detyruara, të paguajnë pagën e humbur në rast sëmundjeje fatkeqësisht vetëm për një kohë relativisht të shkurtër (varësisht nga vitet e shërbimit). Pasi firma juaj ka lidhur një sigurim mëditjesh në rast sëmundjeje, është fatmirësi për ju: Ju duhet sipas të gjitha gjasave të merrni pjesë në gjysmën e sigurimit (gjysmën tjetër e paguan punëdhënësi juaj) dhe në rast sëmundjeje ju merrni si kompensim «vetëm» 80% të pagës së humbur (edhe pse zbritje nga sigurimet shoqërore). Sipas rregullit pagesën ditore (mëditjen) do ta merrni rreth 2 vite, nëse për aq kohë të gjatë do të jeni i sëmurë dhe marrëdhënie e punës do të vlejë më tej.

**KONTROLL I KUJDESHËM.** Se a do të vazhdoj më tej marrëdhënia e juaj e punës, varet nga ajo se, a ka lidhur punëdhënësi juaj një sigurim të mëditjeve të sëmundjes sipas KVG/LAMal apo sipas VVG/LCA. Tek sigurimi sipas KVG/LAMal, nuk jeni më pjesë e sigurimit kolektiv të kompanisë suaj, por keni të drejtë të jeni të siguruar për pagesën ditore, pavarësisht nga një sëmundje ekzistuese. Megjithatë, ju do të duhet të paguani vetë preminë e plotë. Sigurimi sipas VVG/LCA është aktualisht më i zakonshëm. Ky ka avantazhin se pas përfundimit të kontratës së punës, zakonisht parashihet e ashtuquajtura e drejtë për përfitime suplementare. Kjo do të thotë se sigurimi i mëparshëm kolektiv i pagesës ditore për sëmundje vazhdon të paguajë kompensimet ditore të mbetura (ende të pa «shfrytëzuara»), me kusht që kompensimet ditore të sëmundjes të ishin dhënë tashmë gjatë marrëdhënies së punës. Dhe: edhe preminë në këtë rast nuk duhet t'i paguani vetë. Për t'u siguruar nëse është pikërisht kështu, duhet të kërkoni dhe studioni kushtet e përgjithshme të sigurimit!

Nëse keni pasiguri dhe pyetje të tjera shtesë, ju sugjeroj, të drejtoheni tek seksioni juaj i Unia.

(Work, 4.2.2022)

### Mësimi i zanatit-murator: E drejta në gjashtë javë pushim vjetor?

Në fillim të gushtit kam filluar mësimin e zanatit të muratorit. Një kolege shegertë më ka thënë, se ajo ka gjashtë javë pushime vjetore. Sipas kontratës sime unë kam vetëm pesë javë pushim vjetor. A do të duhej që edhe unë të kem gjatë javë pushime?

**PHILIP THOMAS:** Po. Sipas të drejtës obliguese punëmarrësit kanë të drejtë në shtëpi paku pesë javë pushim vjetor. Për profesionin e muratorit nuk janë përcaktuese vetëm rregullat e të drejtës obliguese. Vlen edhe kontrata kombëtare e punës për ndërtimtarinë kryesore (KKP). Kjo përmban edhe rregullat për mësimin e zanatit. Sipas KKP ata që janë duke u arsimuar kanë të drejtë në gjatë javë pushim vjetor. Kjo pra domethënë se kontrata jote e arsimimit profesional duhet të përshtatet me rregullat e KKP dhe se ju në fakt keni të drejtë në gjatë javë pushim vjetor.

Work, 4 shtator 2020

## Kontributi i diasporës për botën e punës në Kosovë Për sindikata në shërbim të anëtarëve dhe klasës punëtore në Kosovë

Punonjësit e Kosovës janë të shfrytëzuar rëndë. Edhe pse luajnë rol kyç në procesin e punës në sektorin privat dhe shtetërorë, ata trajtohen në mënyrë çnjerëzore. Sidomos në sektorin privat. Këtu kanë dështuar edhe sindikatat, të cilat janë ende duke u përballur me një krizë serioze: zvogëlimi i numrit të anëtarëve, ankorim i varfër para së gjithash në sektorin privat, ankorim i varfër në regjione, fragmentim (copëtim) i sindikatave, varësia nga partitë politike në pushtet, përfshirje në procesin e privatizimit dhe shpronësimit të pasurisë shoqërore.

Përgatiti dhe përshtati: Osman Osmani, 21.03.2022

Shkelja e të drejtave të punëtorëve është prezent si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Moszbatimi i ligjit të punës; mos-respektimi i orarit 8 orësh, mungesa e kontratave të punës dhe e rrogës të garantuar minimale, mungesa e mbrojtjes ligjore në rast, lëndimi apo rrezikimi të shëndetit në punë, mos-pagesa për orët shtesë të punës, mbrojtja e shëndetit dhe siguria në vendin e punës etj. Shtu kësaj edhe mungesën e një sistemi të sigurisë elementare shoqërore në vend, bënë edhe më rëndë situatën e punëmarrësve dhe shumicën e popullatës së aftë për punë në Kosovë, të cilët në mungesë të perspektivës jetësore preferojnë migrimin e parregullt.

### Sindikatat: pjesë e zgjidhjes apo edhe e problemit

Po ndalem së pari te pjesa e problemit. Sindikatat kanë dështuar për të mbrojtur interesat e klasës punëtore në vend. Përveç disa protestave të organizuara në sektorin e Shëndetësisë dhe Arsim, ato nuk kanë pasur një plan afatgjatë dhe strategji përkatëse për të mbrojtur anëtarët e tyre dhe klasën punëtore nga pasojat e ekonomisë së pasluftës, procesin kaotik të privatizimit dhe mbrojtjen e pasurisë shoqërore, sidomos të fabrikave dhe ndërmarrjeve shoqërore. Sindikatat kanë dështuar edhe në krijimin e një raporti të forcave në favor të punëtorëve. Bile edhe vetë eksponent të sindikatave e pranojnë se kanë qenë pjesë e agjendës politike, qoftë për të mos rrezikuar procesin e pavarësisë, qoftë për ruajtjen e paqes sociale në favor të shtet formimit. Kjo është shfrytëzuar nga ndërmarrjet, strukturat shtetërore dhe investitorët e shumtë për të çrregulluar plotësisht tregun e punës dhe instalimin e një ekonomie të egër, e cila ishte e orientuar drejt profiteve maksimale për shtresën e pasur.

Sindikatat munden me qenë pjesë e zgjidhjes së problemit. Kjo është gjithmonë e mundur. Duhet një reformë gjithëpërfshirëse për t'u bërë faktor vendimtar dhe shtytëse e interesave të punonjëseve. Për këtë kërkohet dhe një vullnet i theksuar, sidomos në udhëheqjen Sindikale, që të lëvizin gjërat përpara. Ky do të ishte rasti ideal. Një udhëheqësi, e cila nisë vetvetiu procesin e reformimit. Nëse kjo nuk ndodhë atëherë lypet një angazhim nga jashtë, sidomos nga anëtarësia e sindikatës, që të detyrohet aparati i paguar Sindikal të bëjë reforma. Pa një reformë thelbësore, nuk do të mund të adresohen problemet e shumta të fuqisë punëtore në vend.

Do të ishte e nevojshme formulimi i një projekti reformues sindikal me qëllime të qarta: Tejkalmi i copëzimit sindikal, organizimi ndër-profesional dhe ndër-sektorial, ankorim nëpër regjione, organizimi i shkretëtirave sindikale, rritja e aftësisë mobilizuese, pavarësia politike nga pushtetarët, strategjia e lobimit politik, përforcimi i bashkëpunimit sindikalist në përgjithësi.

Pikënisje për jetësimin e këtij projekti të mundshëm do të ishte bashkëpunimi i sindikatave të veçanta përparimtare dhe të gatshme për reforma në bashkëpunim konkret, si dhe kooperimi me faktor tjerë nga jeta publike e politike. Nuk rekomandohet



një reformë e tërësishme «nga lart», kjo d.m.th. përmes çatisë së sindikatave të bashkuara, pasi që një gjë e tillë nuk funksionon, sikurse tregojnë shembujt e shumtë në Evropë.

Në një projekt të mundshëm për fuqizimin e sindikatave në Kosovë do të mund të kontribuonin edhe sindikalistët shqiptar-zviceran bashkë me Sindikatat e Zvicrës dhe partnerët e tyre si Solidar Suisse e Solifonds si dhe përfshirjes të paraparë përkatës të diasporës së Kosovës në politikën e zhvillim-bashkëpunimit ndërshtetëror.

Këto përfundime të përgjithshme në formë rekomandimesh për një projekt ndër të tjera të janë rezultat nga tri takimet e punës që janë zhvilluar gjatë vitit 2012/2013 mes Hilmi Gashit, Hans Schäppi, Ruzhdi Ibrahimit, Osman Osmani. Si të tilla këto rekomandime janë prezantuar me 15 qershor 2013 në Konferencën e mbajtur në Bernë të Zvicrës: «Gjendja sociale në Kosovë: analizë, sfidat dhe propozimet për tejkalm të gjendjes së rëndë».

Ndërsa në konferencën «Kosova në Lëvizje» e organizuar me 18 qershor 2021 nga Partia Socialdemokrate e Zvicrës morën pjesë rreth 60 pjesëmarrës nga Zvicra, Kosova dhe vende tjera të Ballkanit perëndimor. Aty u diskutua se çfarë kontributi mund të jap diaspora për zhvillimin demokratik dhe të qëndrueshëm të Kosovës dhe u aprovua unanimisht një rezolutë, ku në lidhje me këtë çështje adresohet kërkesa dhe pritshmëria vijuese: «Ne presim nga të gjithë aktorët politik e shoqëror që përmes mbështetjes dhe përfshirjes së diasporës të kontribuojnë për ndërtimin e sindikatave të pavarura dhe të fuqishme. Vetëm me sindikata të forta dhe shoqata të punëdhënësve të afta për të negociuar, partnerët socialë mund të negociojnë dhe zbatojnë zgjidhje të qëndrueshme e të përgjithshme (kontrata kolektive të punës, marrëveshjet kolektive). Këto krijojnë bazamentin për paga të mira dhe të drejta dhe kushte të mira dhe të sigurt të punës si dhe zhvillimin e një sistemi të fortë të aftësisimit profesional. Pos tjerash ne presim që qeveria e Kosovës të futë pagën minimale, premtim ky i saj në fushatën zgjedhore.»



### 1 Maji 2022 në Zvicër

Paqe. Liri. Solidarizim – kjo është motoja për 1 Majin e vitit 2022. Ne do të shprehim qëndrimin tonë kundër luftës dhe për ata, të cilët iu duhet të vuajnë nga ky agresion. Në Ukrainë nuk është më e mundur për shumicën që të jetojnë e punojnë normalisht. Peshën më të rëndë të luftës gjithmonë e bartin punëtorët dhe punëtorët e thjeshtë dhe të dobët të varfëritë. Ftesa e plotë e një majit: [www.mai2022.ch](http://www.mai2022.ch)